**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2025/0265**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahii-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "PROGLOBAL" SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të "KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS" sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne punë" me numër të prokurimit KEK-24-1490-1-1-1, me 19/06/2025, mori:

# Vendim

**1. Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "PROGLOBAL" SH.P.K. me nr. 2025/0265, e datës 12/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne punë" me numër të prokurimit KEK-24-1490-1-1-1.

**2. Anulohet,** B58Njoftimi mbi Vendimin e AK të "KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS" sh.a., ndërkaq aktiviteti i prokurimit "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne punë" me numër të prokurimit KEK-24-1490-1-1-1 kthehet në **Rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

# Arsyetim

***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me 15.03.2024, "KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS" sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne punë" me nr. të prokurimit: KEK-24-1490-1-1-1. Ndërsa me datën 26.03.2025 B58Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, kontratë kornizë me një Operator Ekonomik, vlera e parashikuar e kontratës: LOT 2: 446,933.00 Euro.

Me 30.03.2025, OE "PROGLOBAL" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 04.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "PROGLOBAL" SH.P.K me nr. 2025/0265 për lidhur me aktivitetin "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne punë" me nr. të prokurimit: KEK-24-1490-1-1-1.

***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PROGLOBAL" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Ky aktivitet i prokurimit, ne AK – KEK sha, nga dy komisionet paraprake te vlerësimit është vlerësuar kundërligjshëm dhe si fillim është kontestuar lartësia e çizmeve, produkt i aplikuar ne këtë aktiviteti, ku neve si kompani kemi dhënë arsyetimin tone bazuar ne prova dhe dëshmi dokumentare por çuditërisht AK, tenton te anuloj procedurën kundërligjshëm, si rrjedhoje ne si OE, bazuar ne afatet e parapara me LPP, kemi kërkuar vlerësim real dhe konkret, ku se fundmi me datën 01.04.2025, kemi parashtruar kërkesë për ri shqyrtim dhe kemi dhënë dëshmi konkrete, por AK – KEK sha me vendimin e datës 04.04.2025, ka refuzuar kërkesën tone dhe ka lënë ne fuqi vendimin e saje për anulim edhe pse i njëjti është i kundërligjshëm andaj sipas nenit 109 te LPP-se paraqesim argumentet tona:

Pretendimi 1

AK – KEK sha me vendimin e datës 04.04.2025, ka refuzuar kërkesën tone si te pa bazuar, ndërsa ne arsyetimin e saje potencohet se për pozicionin nr. 4 nuk keni dorëzuar dimensionet qe janë kërkuar ne specifika teknike te detyrueshme lidhur me lartësinë e çizmeve. Konstatimi i tille NUK QENDRON. Qeshtja e lartësisë te çizmes është sqaruar përmes deklaratës se datës 16.10.2025, pavarësisht kësaj përsëri AK – KEK sha sipas vendimit te saje nuk i ka zbatuar dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se dhe përsëri nuk i ka trajtuar te gjitha pretendimet tona

ankimore.

Prova 1 – Sqarimi i tenderit përmes Letrës standarde

Ne letër standarde mbi arsyet e eliminimit potencohen arsye te cilat nuk korrespondojnë me kërkesat kualifikuese dhe me gjendjen faktike te ofertës sonë.

Gjegjësisht konstatimi i AK për Pozicioni 1, se për AK ka kërkuar S3 SRC ndërsa është ofruar S2/S3 SRC dhe mungojnë te dhënat e mbrojtjes se gishtërinjve 200J, NUK QENDRON.

Ne katalogun dorëzuar me oferte, faqe 3 shihet qarte se te gjitha këpucët e sigurisë te tipeve S1, S2, S3 janë me mbrojtje te gishtërinjve prej 200J.

S2/S3 SRC nuk ekziston standard, si është tentu nga AK te deformohet.

Pozicioni 1:

Konstatimi i AK për Pozicioni 2, se është kërkuar S3 SRC ndërsa është ofruar S2/S3 SRC dhe mungojnë te dhënat e mbrojtjes se gishtërinjve 200J, NUK QËNDRON. Ne provat e prezantuara me sipër te cilat janë edhe ne oferte tregojnë se këpucët i plotësojnë ne tërësi specifikat teknike te detyrueshme dhe kërkesat tjera te dosjes se tenderit.

Ne katalogun dorëzuara me oferte, faqe 3 shihet qarte se te gjitha këpucët e sigurisë te tipeve S1, S2, S3 janë me mbrojtje te gishtërinjve prej 200J

Pozcioni 2:

Simboli ne katalog S2/S3 SRC nënkupton se i njëjti model këpucëve prodhohet me mbrojtje S2 SRC dhe S3 SRC, ndërsa ne, ne katalog kemi shenjezuar modelin S3 SRC te ofruar.

Ne katalog është shenjezu S3 SRC me te cilin model kemi ofertu dhe kjo kjarte tregon për vlerësim te njeaneshem dhe mos marrje te pergjegjesise ne vlerësim te ofertave.

Edhe ne Test-raportet nga laboratori, shihet se këpucët janë me mbrojtje prej (200) J

Prova 2: Katalogu për këpucë pjese e ofertës

Prova 3: Test raporti nga Laboratori (faqe 9) për mbrojtje prej (200) J – këpucë te cekta

Prova 4: Test raporti nga Laboratori (faqe 8) për mbrojtje prej (200) J – këpucë te thella

Pretendimi 2

Konstatimi i AK – KEK sha për Pozicioni 3, ka potencuar se është kërkuar S5 SRC ndërsa është ofruar vetëm SR, nuk është ofruar mbrojtja e kërkuar 1000V – 25°C, nuk janë ofruar me ngjyrën e kërkuar (te verdhe) por te zeze, ky arsyetim NUK QËNDRON,

Nivelet e mbrojtjes SRA, SRB dhe SRC sipas Standardit EN ISO 20345:2018,

Me rregulloren e re te BE (SRA, SRB dhe SRC) zëvendësohen me nivelin me te larte te mbrojtjes SR te Standardit me te ri EN ISO 20345:2022.

Me ofertë kemi bashkëngjit dhe deklaratën e prodhuesit me sqarimet se çizmet janë te prodhuara me standardin me te ri te aplikueshëm EN ISO 20345:2022 me nivelin e mbrojtjes kundër rrëshqitjes SR. Me eksplorim ne internet lehtësisht vërtetohet se niveli i mbrojtjes SR është Stadardi me i ri i aplikueshëm EN ISO 20345:2022 (ne vend te standardit te vjetër SRA, SRA dhe SRC, EN 20345:2018).

New features in Slip Resistance (SR) – angl.

The new EN ISO 20345:2022 standard has abolished the SRA, SRB, and SRC markings for slip resistance. Instead, every shoe must meet a basic slip resistance requirement on ceramic tiles with a detergent solution, but this is no longer marked separately.

Shoe soles can optionally undergo an additional test with glycerin on ceramic tiles. If they pass, they receive the SR marking for the highest level of slip resistance. Shoes according to the old standard retain their markings (SRA, SRB, or SRC) until their certificates expire.

Karakteristikat e reja në Rezistencën ndaj rrëshqitjes (SR) – shqip

Standardi i ri EN ISO 20345:2022 ka hequr shenjat SRA, SRB dhe SRC për rezistencën ndaj rrëshqitjes. Në vend të kësaj, çdo këpucë duhet të plotësojë një kërkesë bazë të rezistencës ndaj rrëshqitjes në pllakat qeramike me një zgjidhje detergjente, por kjo nuk shënohet më veçmas.

Thembra e këpucëve mund t'i nënshtrohen opsionalisht një prove shtesë me glicerinë në pllaka qeramike. Nëse kalojnë, ata marrin shenjën SR për nivelin më të lartë të rezistencës ndaj rrëshqitjes. Këpucët sipas standardit të vjetër ruajnë shenjat e tyre (SRA, SRB ose SRC) deri në skadimin e certifikatave të tyre.

Me Standardin me te ri SRA, SRB dhe SRC zëvendësohen me SR dhe për këtë qeshjte komisioni vlerësues i ofertave bazuar ne dispozitat ligjore te nenit 59 te LPP-se, përveç vlerësimit te ofertave duhet ti ekzaminoi dhe ti krahasoi te njëjtat ne atë mënyrë qe te respektohen te paktën parimet bazike te ligjit për Prokurim Publik.

Prova 5 – SR konfirmimi nga prodhuesi

Çizmet e ofruara janë me mbrojtje sipas kushteve te TD dhe janë ngjyre te verdhe.

Gjithashtu plotësojnë kushtet 1000V - 25°C.

Janë me performanca edhe me te mira dhe ofrojnë siguri me te larte se sa është specifiku ne Aneksi 1, si:

• • Mund te përdoren për tension deri 17kV (17000 V),

• • Gome e vullkanizuar rezistencë ndaj prerjes

• • Rezistencë ndaj nxehtësisë deri 300°C

• • Izolimi i ftohtë sipas EN ISO 20345:2022 CI (Cold insulation to EN ISO 20345:2022 CI, angl.)

• • Shtroje e bute ergonomike

• • Sistemi që thith energjinë në thembër sipas EN 20345:2022 E

• • Afati i përdorimit 10 vite

Gjithashtu janë me ngjyre te verdhe.

Prova 6 – Catalogu pozicion 3 per Qizme

Pretendimi 3

Konstatimi i AK për Pozicioni 4, ne arsyetim te eliminimit, se nuk figuron gjatësia e çizmeve, NUK QËNDRON, për faktin se:

Katalogët e prodhuesve për çizme, këpucë etj, përmbajnë te dhënat teknike qe kane te bëjnë me kualitetin sipas EN Standardeve si dhe përbërjen e materialeve nga te cilat prodhohen.

Te dhëna tjera teknike qe ne fazën e prodhimit dhe sipas porosisë mund te përshtaten, si lartësia etj..., nuk i përshkruajnë prodhuesit ne katalog.

Me oferte kemi dorëzua mostrën e cila është e matshme. (për te cilën neve si OE, propozojmë qe eksperti shqyrtues apo edhe paneli shqyrtues te kërkoj nga AK, qe ta prezantoj mostren për ekzaminim dhe vlerësim gjate shqyrtimit te ankesës sonë ashtu siç përcaktohet me nenin 105, 113 dhe 114 te LPP-se)

Ndërsa gjate procesit te evaluimit përmes sqarimeve ne si OE jemi zotu përmes deklaratës se çizmet do ti dorëzojmë sipas Aneksi 1 te TD ashtu siç është përcaktuar, ashtu siç është kërkuar sqarim dhe ashtu siç e parashef ligji ne fuqi.

Me ligj për prokurim publik, pas lidhjes se kontratës për secilin produkt secili AK përkatës, duhet te formoj komision te pranimit te produkteve dhe te njëjtit do te pranojnë produktet te cilat korrespondojnë me specifikat e përcaktuara ne dosje te tenderit, prandaj qeshtja e specifikave teknike nuk është kërkesë kualifikuese por është kërkesë implementuese e kontratës, pra prokurimi publik i ka fazan e saja dhe AK, nuk mund te eleminoi ofertën për fare te ardhme dhe te pa konsumuar ende, ku AK – KEK sha me vendimin e datës 04.04.2025, nuk i ka trajtuar pretendimet tona te njëjtat i ka anashkaluar dhe ka shkelur dispozitat ligjore nga neni 108/A i LPP-se.

Prova 7 - Deklarata për lartësinë e çizmeve përmes Sqarimeve

Me nenin 52.3 dhe me nenin 56.3 te LPP-se përcaktohet:

- “ Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Komisioni vlerësues dhe ri - vlerësues ne vazhdimësi kane ndryshuar arsyetimet e eliminimit dhe ne vazhdimësi kane përshkruar arsye qe NUK qëndrojnë, te cilat nuk janë kërkesa kualifikuese te përcaktuara as ne dosje te tenderit dhe as ne njoftim për kontrate, si rrjedhoje anulimi i aktiviteti te prokurimit me arsyetim te pa qene bie ndesh me nenin 62, te LPP-se

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "PROGLOBAL" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim IGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit, Neni 27 Dosja e Tenderit, Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mos marrëveshjeve, Rregullorja me nr 001/2022, për Prokurim Publik, Neni 17 Dosja e Tenderit, Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 97 Shkeljet e rënda. Prandaj Operatori Ekonomik ankues "Proglobal Shpk, kërkon qe OSHP dhe zyrtaret përgjegjës sipas nenit 113 dhe 114 te LPP-se te trajtojnë pretendimet ankimore te dorëzuara ne AK dhe te anashkaluara nga AK, ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerr këtë: V E N D I M te Aprovohet, ne tërësi e bazuar ankesa e OE "Progobal SHPK si e bazuar. Anulohet, si i kunderligjeshem njoftimi për anulimin e lotit 2 dhe lënda kthehet ne Ri-vlerësim te AK – KEK sha. Lejohet, kthimi i mjeteve te deponuara ne emër te ankesës. Kompania jone si rezultat i shkeljeve ligjore dhe mos prezantimit te dëshmive ne formën siç janë ne këtë procedure te prokurimit është dëmtuar dhe bazuar ne provat dhe dëshmitë materiale detyrohemi lenden ta procedojmë edhe ne organe tjera.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Refuzohet e pabazuar kërkesa e paraqitur për rishqyrtim nga PROGLOBAL SH.P.K.., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne pune", për LOT 2: "Furnizim me këpucë dhe çizme sigurie me nr. prokurimit KEK-24-1490-1-1-1

ANALIZA DHE SQARIMI: Ne kemi pranuar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne pune, për LOT 2: Furnizim me këpucë dhe çizme sigurie me nr. prokurimit KLK-24-1490-1-1- 1 ku ju pretendoni se dispozitat e LPP-së janë shkelur nga ana e komisionit të Autoritetit Kontraktues,

Për informatën tuaj bazuar ne pretendimin e juaj ankimor dhënë ne kërkesën për rishqyrtim ju njoftojmë se komisioni i rivlerësimit mbetet pas vlerësimit te bërë, ku ju nuk keni plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit.

Lidhur me pretendimet e juaj, komisioni i rivlerësimit teknik nuk i keni plotësuar dhe mbetet pas rivlerësimit te bere dhe pranimit te njoftimit për eliminim.

-Konstatimi i AK për Pozicioni 3, se është kërkuar S5 SRC ndërsa është ofruar vetëm SR, ruk është ofruar mbrojtja e kërkuar 1000V - 25°C, nuk janë ofruar me ngjyrën e kërkuar (te verdhe) por te zeze, NUK QENDRON.

Nivelet e mbrojtjes SRA, SRB dhe SRC sipas Standardit EN ISO 20345:2018.

Me rregulloren e re te BE (SRA, SRB dhe SRC) zëvendësohen me nivelin me te larte te ndrojtjes SR te Standardit me te ri EN ISO 20345:2022.

Me oferte kemi bashkëngjit dhe mail - Deklaratën e prodhuesit me sqarime se çizmet janë t ? prodhuara me standardin me te ri te aplikueshëm EN ISO 20345:2022 me nivelin e mbrojtjes kundër rrësf qitjes SR. Me një eksplorim ne internet lehtësisht vërtetohet se niveli i mbrojtjes SR është Stat dardi me i ri i aplikueshëm EN ISO 20345:2022 (ne vend te standardit te vjetër SRA, SRA dhe SRC, EN 203 45:2018).

Përgjigje : Ju si operator ekonomik potencial gjate fazës se tenderimit dhe afateve për parashtrim te pyetjeve sqaruese nuk iu keni preferuar nenit Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit qe te qartësoni dhe jepni informata ashtu siç jepni tani ne kërkesën për rishqyrtim.

Paragrafi 1. Gjatë përgatitjes së tenderit, çdo operatorë ekonomik mund të bëjë kërkesë ? me shkrim te autoriteti përkatës kontraktues për çfarëdo informate apo sqarim shtesë që operatori ekonomik beson se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi përkatës, me kusht që çdo kërkesë e tillë me shkrim të pranohet nga autoriteti kontraktues:

Kjo është në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës të përcaktua a në Nenin 6 të ligjit, i cili kërkon që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese.

- Konstatimi i AK për Pozicioni 4, se nuk figuron gjatësia e çizmeve, NUK QENDRON.

Ky komisioni i rivlerësimit ju sqaron se ju ne ofertën e juaj nuk i keni dorëzuar dimensioni c e është kërkuar ne specifikimin teknik te detyrueshëm lidhur me gjatësinë çizmeve bazuar ne specifikimin teknik si dhe përgjigjja ndaj përgjigjes për pyetjen e parashtruar për këtë çështje te dimensionit te gjatë së se çizmeve.

Pra për sqarimet qe i keni pranuar para dorëzimit te ofertës, ne si komision nuk mundemi ligjërisht për te njëjtën çështje qe nju nuk e keni dorëzuar ne oferte te ju parashtrohet pyetje sqarues për plotësim te specifikimit teknik .

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nëse një operator e ekonomik nuk ka ofruar karakteristikat teknike të kërkuara në specifikimin teknik të detyrueshëm, autoriteti kontraktues mund ta eliminojë atë nga procedura e prokurimit. Kjo bazohet në Nenin 59 të këtij ligji, i cili trajton specifikimet teknike dhe kërkesat për to.

Neni 59 përcakton që:

Specifikimet teknike duhet të formulohen në mënyrë që të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe të mos krijojnë barriera të panevojshme në konkurrencë.

Autoriteti kontraktues duhet të përfshijë në dosjen e tenderit të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale që duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë.

Nëse një operator ekonomik nuk i përmbush këto kërkesa teknike të detyrueshme, autoriteti kontraktues ka të drejtë ta skualifikoje atë nga procedura e prokurimit. Kjo është në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës të përcaktuara në Nenin 6 të ligjit, i cili kërkon që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese.

Prandaj, nëse një operator ekonomik nuk ka ofruar karakteristikat teknike të kërkuar në specifikimin teknik të detyrueshëm, autoriteti kontraktues mund ta eliminojë atë na procedura e prokurimit, duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për Prokurimin Publik. Pas te gjithave qe u sqaruar me lartë, komisioni i rivlerësimit mbetet ne vendimin e marr bazuar në kërkesën e pabazuar ne njoftimi qe ju ka dërguar Autoriteti Kontraktues dhe kërkesa për rishqyrtim ju refuzohet si e pabazuar, dhe mbetet vendimi i autoritetit kontraktues ne fuqi

REKOMANDIMI I KOMISIONITTE RIVLERESIMIT ; Komisioni i vlerësimit rekomandon zyrtarin përgjegjës te prokurimit që kërkesa për rishqyrtim e OE PROGLOBAL SH.P.K.., lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne pune, për LOT 2: Furnizim me këpucë dhe çizme sigurie me nr. prokurimit KEK-24-1490-1-1-1, dhe kërkesa për rishqyrtim të refuzohet

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT: Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim e OE PROGLOBAL SH.P.K.., lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne pune, për LOT 2: Furnizim me këpucë dhe çizme sigurie me nr. prokurimit KEK-24-1490-1-1-1, si dhe duke u bazuar edhe ne sqarimet e komisioni rivlerësues, ka vlerësuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar dhe ka vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0265/2025, ndërsa me datë 27.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0265/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhen përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth raportit te ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "PROGLOBAL" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0265 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim: Eksperti shqyrtues, në përputhje me kërkesat e PSH-së, ka kërkuar qasje në mostrat e OE-së ankues. Këtë qasje e ka realizuar dhe vërtetuar më datë 25.01.2025. Fotografitë e paraqitura në ekspertizë janë marrë nga mostrat fizike të OE-së ankues.

AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me datën 15.11.2024. OE ankues ka bere kërkesë për rishqyrtim ne vendimin e AK-se me datën 19.11.2024 ndërsa me datën 26.11.2024 AK e ka nxjerre vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim duke e vlerësuar si pjesërisht te bazuar dhe e ka kthyer lenden ne rivlerësim.

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin që ka të bëjë me pozicionin 1 të LOT 2 - Aneksit 1 të dosjes së tenderit, sipas FDT-së është kërkuar:

Këpucë pune sigurie industriale te cektë

Materiali: lëkurë, 1.8-2.00mm

Brendësia e këpucës: tekstil

Shualli (Gjoni) i këpucës :SRC

EN ISO 20345:2011 CE S3

-Kapaku i çelikut për mbrojtjen e gishtërinjve të jetë 200J,

-Niveli I mbrojtjes të jetë S3 me vlerat SRC kundër rrëshqitjes

-Të jenë rezistence ndaj agjentëve dhe vajrave kimike.

Certifikata e konfirmitetit obligative, mostra obligative

Këpuca të ketë ngjyrë të zezë

OE ankues me oferte ka dorëzuar katalogun e prodhuesit NAPRON dhe produktin AS 7000

Autoriteti Kontraktues (AK) e ka eliminuar Operatorin Ekonomik (OE) ankimues me arsyetimin: "Është kërkuar S3 SRC, ndërsa është ofruar S2/S3 SRC dhe mungojnë të dhënat e mbrojtjes së gishtërinjve."

Eksperti shqyrtues, me qëllim verifikimin e mostrave, ka vizituar AK-në dhe ka marrë dëshmitë e mostrave si më poshtë:

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, me rastin e vlerësimit, i është referuar vetëm katalogut të prodhuesit, ku numri i katalogut i referohet rangut të produkteve që prodhohen për atë lloj produkti, duke mos e verifikuar edhe mostrën e dorëzuar. Sikurse shihet qartë në mostrën për produktin me numër katalogu AS 7000, niveli i mbrojtjes për atë produkt është S3. Prandaj, vlerësimi i AK-së se ky kriter nuk është plotësuar nuk është në përputhje me nenin 40 të RRPP nr. 001/2022.

Sa i përket pjesës së pretendimit që ka të bëjë me mbrojtjen e gishtërinjve, sipas katalogut të dorëzuar me ofertë, rezulton se të gjitha produktet me nivel mbrojtjeje S1, S2 dhe S3 — në rastin konkret ku është kërkuar, sipas specifikimeve teknike të FDT-së — kanë mbrojtje të gishtërinjve prej 200J (shih dëshminë)

Prandaj, bazuar në dëshmitë e dorëzuara me ofertë dhe nga kontrollimi i mostrave të dorëzuara, eksperti shqyrtues vlerëson se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë vlerësimit, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40.6 të RRPP nr. 001/2022 dhe se pretendimi është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2:

Lidhur me pretendimin që ka të bëjë me pozicionin 2 të LOT 2 – të Aneksit 1 të dosjes së tenderit, sipas FDT-së është kërkuar:

Këpucë pune sigurie industriale te thella  S3

Materiali: lëkurë, 1.8-2.00mm

Brendësia e këpucës: tekstil

Shualli (Gjoni) i këpucës : SRC

EN ISO 20345:2011 CE S3

-Kapaku  i çelikut  për mbrojtjen e gishtërinjve të jetë 200J,

-Niveli I mbrojtjes të jetë S3 me vlerat SRC kundër rrëshqitjes,

-Të jenë rezistence ndaj agjentëve dhe vajrave kimike.

Certifikata e konfirmitetit obligative,  mostra obligative

Këpucë të ketë ngjyrë të zezë,

OE ankues me oferte ka dorëzuar katalogun e prodhuesit NAPRON AS 8000 si me poshtë:

AK e ka eliminuar OE ankues me te njëjtin arsyetim si ne pretendimin e parë  se "është kërkuar S3 SRC ndërsa është ofertuar me S2/S3 SRC dhe mungojnë te dhënat e mbrojtjes se gishtërinjve".

Eksperti shqyrtues me qellim te verifikimit te mostrave ka vizituar AK-ne dhe ka marre dëshmitë e mostrave si me poshtë:

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, ashtu si në pretendimin e parë, me rastin e vlerësimit i është referuar katalogut të prodhuesit, ku numri i katalogut i referohet rangut të produkteve që prodhohen për atë lloj produkti, duke mos e verifikuar edhe mostrën e dorëzuar. Sikurse shihet qartë në mostrën për produktin me numër katalogu AS 8000, niveli i mbrojtjes për atë produkt është S3. Prandaj, vlerësimi i AK-së se ky kriter nuk është plotësuar nuk është në përputhje me nenin 40 të RRPP nr. 001/2022.

Sa i përket pjesës së pretendimit që ka të bëjë me mbrojtjen e gishtërinjve, po ashtu, njëjtë sikurse në pretendimin e parë, sipas katalogut të dorëzuar me ofertë rezulton se të gjitha produktet me nivel mbrojtjeje S1, S2 dhe S3 — në rastin konkret ku është kërkuar, edhe sipas specifikimit teknik të FDT-së — kanë mbrojtje të gishtërinjve prej 200J (shih dëshminë).

Prandaj, bazuar në dëshmitë e dorëzuara me ofertë dhe nga kontrollimi i mostrave të dorëzuara, eksperti shqyrtues vlerëson se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë vlerësimit, ka vepruar njëjtë sikurse në pretendimin e parë, pra në kundërshtim me nenin 40.6 të RRPP nr. 001/2022, dhe se pretendimi është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.3:

Lidhur me pretendimin qe ka te beje me pozicionin e 3 te LOT 2- te Aneksit 1 te dosjes se tenderit sipas FDT-se është kërkuar:

Çizme sigurie Gome S5 SRC

-Çizmet të jenë të prodhuara sipas standardit EN ISO 20345:2011 SRC

-Niveli I mbrojtjes të jetë  S5 me  me vlerat SRC kundër rrëshqitjes Vajrave

-Thembra te ketë masën e amortizimit ndaj goditjeve rezistent 1000 V  -25C

-Kapaku  i çelikut  për mbrojtjen e gishtërinjve dhe mbrojtje shputa e këmbës poshtë

-Materiali goma e qëndrueshme

Certifikata e konfirmitetit obligative,  mostra obligative

Çizmet të jenë ngjyrë te Verdh

OE ankues me oferte ka ofruar katalogun për Dielectric Boots si me poshtë

AK-ja e ka eliminuar OE-në ankimues me arsyetimin se "është kërkuar S5 SRC, ndërsa është ofruar vetëm SR; si dhe nuk është ofruar mbrojtja 1000V-25°C; nuk janë ofruar me ngjyrën e kërkuar (të verdhë), por në ngjyrë të zezë", duke iu referuar standardit të vitit 2011.

Eksperti shqyrtues me qellim te verifikimit te mostrave ka vizituar AK-ne dhe ka marre dëshminë si me poshtë:

OE-ja, gjatë kërkesës për rishqyrtim, ka sqaruar se, sipas rregullores së re të BE-së, standardet e kërkuara SRA, SRB dhe SRC nuk kërkohen më dhe janë zëvendësuar me SR.

Eksperti shqyrtues, me qëllim që të verifikojë deklarimet e OE-së ankimues dhe duke administruar edhe dëshmitë e dorëzuara me ofertë, si dhe nga verifikimi i "Standardit të ri EN ISO 20345:2022", të publikuar nga CEN dhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian – nga Komiteti Teknik CEN/TC 161 dhe ISO/TC 94/SC 3 që përgatitin këto standarde, ka konstatuar se në publikimet për përditësimet e vitit 2022 është deklaruar se: “requirement on slip resistance revised (5.3.5 and 6.2.10); marking “SRA, SRB and SRC” deleted; marking “SR” and “Ø” introduced“

(kërkesa për rezistencën ndaj rrëshqitjes është rishikuar (5.3.5 dhe 6.2.10); shënimi “SRA, SRB dhe SRC” është hequr; janë futur shënimet “SR” dhe “Ø”

Sa i përket rezistencës se çizmeve te dorëzuara duke u bazuar ne katalogun e prodhuesit rezulton se rezistenca e deklaruar është 17Kv.

Nëse vlera e ofruar konvertohet nga kV në V, atëherë rezulton se vlera e ofruar për rezistencë ndaj goditjeve është 17000 V, që është ofruar me siguri më të lartë sesa është kërkuar me specifikim teknik.

Sa i përket arsyetimit se nuk është ofruar ngjyra e kërkuar, AK-ja nuk e sqaron se cilën mostër ka vlerësuar. Megjithatë, nga fotografia e marrë më lart nga dëshmitë e mostrave fizike të dorëzuara nga OE-ja ankimues, shihet se çizmet janë në ngjyrë të verdhë. Prandaj, AK-ja gjatë vlerësimit nuk e ka dëshmuar se cilës mostër i referohet, rrjedhimisht ka vepruar në kundërshtim me nenet 7 dhe 59 të LPP.

Bazuar në administrimin e provave të marra nga qasja në mostrat e dorëzuara, dëshmitë e dorëzuara me ofertë, si dhe standardin EN ISO 20345:2022 të publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4:

Lidhur me pretendimin që ka të bëjë me pozicionin 4 të LOT 2 – të Aneksit 1 të dosjes së tenderit, sipas FDT-së është kërkuar:

Çizme sigurie lëkurë S3

ISO EN 20345 S3 SRC

-Çizmet të jenë të prodhuara sipas standardit ISO EN 20345

-Niveli I mbrojtjes të jetë S3 me vlerat SRC kundër rrëshqitjes.

-Kapaku i çelikut për mbrojtjen e gishtërinjve të jetë 200J,

-Materiali lëkurë , lartësia mbi 15cm

Certifikata e konfirmitetit obligative, katalogu dhe mostar Standardi CE

Çizmet të jenë ngjyrë të zezë

AK-ja, përmes sqarimeve, e ka ndryshuar thellësinë e çizmeve për produktin në fjalë nga 15 cm në 30 cm. OE-ja me mostër ka dorëzuar produktin me thellësi 28 cm. AK-ja, gjatë vlerësimit të ofertës për këtë pjesë, ka dërguar kërkesë për sqarim më datë 14.10.2024:

OE ankues i është përgjigjur kërkesës me datën 16.10.2024:

AK-ja, me rastin e vlerësimit të ofertave, e ka anuluar tenderin për LOT 2 me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme. Arsyeja e anulimit për OE-në ankimues nuk ka qenë për shkak të thellësisë, por "për shkak se janë ofruar më shumë se dy numra pas presjes dhjetore". Eksperti shqyrtues nuk ka mundur të gjejë arsyetimin e përdorur nga AK-ja me rastin e vlerësimit të sqarimeve të OE-së ankimues si të pranueshme, ndërkohë që këto nuk janë paraqitur si arsyetim në vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj, bazuar në dëshmitë e marra nga e-prokurimi (dosja e tenderit, sqarimet e dhëna nga AK-ja, oferta e OE-së ankimues si dhe sqarimet e marra përmes kërkesave për sqarim), eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, gjatë administrimit, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 38 të Rregullores për Prokurim Publik (RRPP) nr. 001/2022, duke mos marrë parasysh të gjitha dëshmitë në procesin e rivlerësimit, dhe se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit,

përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar.

Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues në raportin e tije ka ofruar dëshmi përmes fotografive, vertifikimin e mostrave të dorëzuara pran AK-se ku dhe konstatimet në raportin e ekspertit lidhur me pretendimet ankimore nga OE ankues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit, dhe në këtë rastë Paneli Shqyrtues mbështet rekomandimin e eksperti shqyrtues.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PROGLOBAL" SH.P.K janë të bazuara duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura ku ka vendosur që aktiviteti i prokurimit me "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse ne punë" me nr. të prokurimit: KEK-24-1490-1-1-1, të anulohet B58Njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim, dhe lënda të kthehet në rivlerësim si dhe AK të veproj në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë..

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahimi**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: